



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË
V E N D I M

Nr. 97 dt.31.07.1995

MBI DHENIEN E NDIHMES EKONOMIKE DHE PERFITIMIN E
PAAFTESISË PER MUAJIN MAJ 1995

Në zbatim të ligjit Nr.7710, dt.19.06.1993 “Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore”, ligjit Nr.7896, 08.12.1994 “Për disa ndryshime në ligjin Nr.7710, dt.18.05.1993”, VKM Nr.453, dt.26.09.1994 “Për dhënie e ndihmës ekonomike” VKM Nr.311, dt.11.07.1994 “Për përfitimin e paaftësisë”, Këshilli Bashkiak, i mbledhur sot më dt.31.07.1995, pasi shqyrtoi dhe relacionin e Seksionit të Përkrahjes Sociale

VENDOSI

1. Për muajin Maj 1995 të përfitojnë ndihmë ekonomike gjithsej **12.859 familje** me një fond prej **27 milion lekë** nga të cilat **12.389 familje** me ndihmë ekonomike të plotë me një fond prej **26.4 milion lekë** dhe **470 familje** me një fond prej **0.6 milion lekë**.
2. Të përfitojnë këto familje **7.3 milion lekë** për kompesimin e energjisë elektrike.
3. Të përfitojnë ndihmë ekonomike si raste të veçanta :

- Shyqyri Dibra, familje me 5 anëtarë, ndihmë ekonomike të pjeshme duke e afruar në nivelin maksimal, Nj.A.1.
- Hatimije Gjoni, familje me 1 anëtarë, ndihmë ekonomike e plotë, Nj.A.7.
- Haxhire Rakipi, familje me 1 anëtarë, ndihmë ekonomike e plotë, Nj.A.7.

3/1. Elton Sadiku, familje me 1 anëtarë, ndihmë ekonomike e plotë, Nj.A.9 nuk përfiton.

4. Të rifuten në skemën e ndihmës ekonomike :

- Astrit Bakullati, familje me 4 anëtarë, Nj.A.1
- Nail Hidri, familje me 3 anëtarë, Nj.A.2
- Skënder Driziu, familje me 3 anëtarë, Nj.A.2
- Bardhyl Birçe, familje me 4 anëtarë, Nj.A.2
- Kastriot Pitari, familje me 5 anëtarë, Nj.A.5

5. T'u ndërpritet ndihme ekonomike **86 familjeve** pasqyrave të bashkëngjitura në relacion.

6. Të përfitojnë ndihmë ekonomike **1.026 persona** me një fond prej **1.5 milion lekë**.

KRYETARI

BESNIK PETRELA